

Vendim nr. 63 datë 23.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 23.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (H) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HELIDON GJIKOKA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1497(307), datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Lënia në fuqi e vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, pika 1, 38, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Helidon Gjikota është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në kuadër të procedimit penal nr. 5670 të vitit 2020 për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi me pasoja të rënda” dhe “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të Kodit Penal (KP), të regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit I. K.

2. Në përfundim të hetimeve, organi i prokurorisë ka vendosur marrjen e kërkuesit në cilësinë e të pandehurit për kryerjen e veprave penale të sipërcituara dhe i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dërgimin në gjyq të këtij procedimi penal.

3. Mbështetur në kërkesën e paraqitur nga organi i prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1545/regj., datë 21.10.2020, ka vendosur: *“1. Caktimin ndaj personit nën hetim Helidon Gjikota [...], si i dyshuar për veprat penale të “Mashtrimin” me pasoja të rënda në dëm të viktimës I. K. dhe “Falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve”, të parashtruara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të KP, të masës së sigurimit “arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodi i Procedurës Penale”.* Kjo masë nuk rezulton të jetë ekzekutuar, për shkak se kërkuesi i është shmangur ekzekutimit të saj, duke u vendosur deklarimi i ikjes sipas nenit 247/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Sipas kërkesës së vetëdorëzimit drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë në datën 08.03.2022, si dhe procesverbalit të datës 10.03.2022, të mbajtur për ekzekutimin e vendimit nr. 1545/1 akti, datë 21.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 10.03.2022 kërkuesi Helidon Gjikota është kthyer nga Britania e Madhe dhe është dorëzuar vullnetarisht pranë Policisë Kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Porti Vlorë.

5. Me vendimin nr. 1288 regj., datë 07.05.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur: *“Shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin e çështjes penale [...]. Dërgimin e akteve për shqyrtim në gjykatën kompetente, atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (seancës paraprake).”.*

6. Në vijim, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 105 regj. them., datë 12.03.2022, ka vendosur vijimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj kërkuesit, duke vlerësuar se ekziston një nga tre kushtet e veçanta të parashikuara në nenin 228 të KPP-së, konkretisht ai i rrezikut i largimit të tij për t’iu shmangur hetimit dhe gjykimit. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 105 regj. them., datë 12.03.2022 dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” ndaj kërkuesit.

8. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” caktuar ndaj tij, me një masë sigurimi më të butë. Me vendimin nr. 165, datë 04.05.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Helidon Gjikota me objekt zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, pasi ka vlerësuar se në rastin konkret nevojat e sigurimit nuk janë zbutur dhe masa e sigurimit “Arrest shtëpie” vazhdon t’i përgjigjet rëndësisë së faktit. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesi.*

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 166, datë 18.05.2022, ka vendosur: *“1. Ndryshimin e vendimin nr.165, datë 04.05.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në këtë mënyrë: “- Pranimin e kërkesës së paraqitur nga ana e të pandehurit Helidon Gjikota, me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, me një masë tjetër më të butë”. - Zëvendësimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në shtëpi” caktuar ndaj të pandehurit Helidon Gjikota me vendimin nr. 570, datë 24.03.2022 të Gjykatës së apelit Vlorë me masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Garancia pasurore”, parashikuar nga nenet 234 dhe 236 të K.Pr.Penale. -Urdhëroret i pandehuri Helidon Gjikota për depozitimin pranë një banke të nivelit të dytë, të shumës së garancisë pasurore në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë të reja, brenda datës 19.05.2022. – Urdhërohet i pandehuri Helidon Gjikota për njoftimin menjëherë të prokurorit për depozitimin e shumës së garancisë pasurore. – Ngarkohet prokurori i çështjes që menjëherë pas njoftimit të depozitimit, por në çdo rast jo më shumë se 24 orë nga ky njoftim, të kryejë verifikimin e dokumentacionit përkatës duke urdhëruar sipas rastit, lirimin e menjëhershëm të pandehurit Helidon Gjikota, ose konfirmimin e masës shtrënguese të “Arrestit në shtëpi”. – Caktimin ndaj të pandehurit Helidon Gjikota të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 14:00. -Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs sipas ligjit në Gjykatën e Lartë.”.*

10. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165 datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se masa e sigurimit zëvendësohet me një masë më të lehtë në rastet kur nevojat e sigurimit zbuten, kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose kur masa e sigurimit e caktuar nuk i përgjigjet dënimit që mund të caktohet, ndërkohë që në rastin objekt gjykimi nuk ekziston asnjëri prej këtyre rasteve. Kërkuesi ka paraqitur kundërrekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1497(307), datë 22.11.2022, ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.*”, duke vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj personit nën hetim është rrjedhojë e zbatimit jo të drejtë të ligjit procedural penal dhe konkretisht nenit 260 të KPP-së, për sa i përket vlerësimit të kushteve për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

12. Në datën 17.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2022-1497 (307), datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar i ka cenuar:

13.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në aspektet e mëposhtme:

13.1.1. *Parimit të gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në tejkalim të kompetencave të caktuara nga neni 432 i KPP-së, duke kryer vlerësim provash. Vendimi nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022 i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ka qenë në dosjen që ka shqyrtuar Gjykata e Lartë dhe, për pasojë, ajo nuk ka pasur mundësi objektive ta lexonte dhe të kuptonte se cilat ishin shkaqet për të cilat është caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi”. Gjykata e Lartë ka kopjuar rekursin e prokurorit të apelit, pa verifikuar nëse ishte i vërtetë. Gjendja e tij familjare dhe sociale, e ngritur në ankim nuk është analizuar dhe nuk ka qenë objekt shqyrtimi e për pasojë nuk ka qenë objekt vlerësimi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

13.1.2 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi akuzat në ngarkim të tij në momentin e paraqitjes së kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit kanë qenë “Falsifikimi i dokumenteve dhe stampave ose i formularëve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 190 dhe 186 të KP-së, e jo siç arsyeton Gjykata e Lartë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të KP-së.

- 13.2. *Të drejtën e lëvizjes së lirë*, të parashikuar në nenin 38 të Kushtetutës, si rrjedhojë e kufizimit të së drejtës së lëvizjes lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit, si dhe për të dalë jashtë shtetit, për shkak të caktimit të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”.
- 13.3. *Parimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale*, të parashikuar nga neni 148 i Kushtetutës, në drejtim edhe të *parimit të sigurisë juridike*, pasi në vendimin objekt ankimi Gjykata e Lartë ka pranuar argumentet e prokurorisë në rekurs, ndonëse rekursi nuk është bërë nga prokurori i çështjes dhe nuk mbështet qëndrimin e këtij të fundit. Mendimi i shfaqur nga prokurori i çështjes në gjykimin në shkallë të parë ka qenë për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj tij, me dy masa të tjera siguri më të buta. Sipas nenit 244/3 të KPP-së, gjykata nuk mund të caktojë një masë siguri më të rëndë nga ajo e kërkuar nga prokurori. Prokuroria është organi që vendos se cila është masa e sigurimit më e përshtatshme, ndërsa gjykata ka kompetencë të vendosë një masë siguri më të lehtë, por kurrësi më të rëndë.
- 13.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës, pasi tre gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kanë arsyetuar ndryshe në çështjen e tij, në dallim nga çështje të tjera të ngjashme, duke mbajtur dy standarde të ndryshme gjykimi. Në vendimin nr. 00-2022-1823 (332), datë 15.12.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se prokurori i apelit nuk mund të ndryshojë linjën e qëndrimit të prokurorit të shkallës së parë. Nëse ai bën një gjë të tillë, mendimi i tij nuk është detyrues dhe as kushtëzon vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Ndërkohë, në çështjen e tij, Gjykata e Lartë e ka interpretuar ligjin ndryshe, duke e vënë kërkuesin në pozitë jo të barabartë me shtetas të tjerë dhe duke rënduar pozitën e tij, në cenim kjo edhe të *parimit të sigurisë juridike*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit.

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose

juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

16. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

17. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkolet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm kur plotësohen disa kriteret që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës së individit. Në këtë kuptim, vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar. Po ashtu, ky lloj vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në

masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Po aq rëndësi ka edhe fakti që shkelja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e shkeljes së të drejtës kushtetuese (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në gjykatë procedurat gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në shtëpi”, të cilat kanë përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1497 (307), datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Procedurat e këtij lloji, për nga natyra e tyre, janë të tilla që i nënshtrohen juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, për sa i përket objektit të kërkesës për kundërshtimin e vendimit gjyqësor të dhënë nga Gjykata e Lartë, vlerësohet se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese që pretendon se i janë shkelur.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 22.11.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 17.02.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

21. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së në drejtim të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor; të drejtën e lëvizjes së lirë, të garantuar nga neni 38 i Kushtetutës; parimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, të garantuar nga neni 148 i Kushtetutës; parimin e barazisë para ligjit, të garantuar nga neni 18, pika 1, i Kushtetutës, në cenim kjo edhe të *parimit të sigurisë juridike*.

22. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e lirisë së lëvizjes, të garantuar nga neni 38 i Kushtetutës, Kolegji vlerëson se, në thelb, ka të bëjë me cenimin e së drejtës së lirisë personale, të parashikuar nga nenet 27, pikat 1 dhe 2, shkronja “c” dhe 28, pika 3, të Kushtetutës si dhe neni 5, pika 1, shkronja “c”, i KEDNJ-së, e cila, në rastin konkret, nuk mund të kufizohet pa një vendim gjyqësor. Për rrjedhojë, bazuar në parimin *iura novit curia*, e drejta e lirisë së lëvizjes do të analizohet në drejtim të së drejtës së lirisë personale të ndërthurur me të drejtën për proces të rregullt ligjor.

23. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se liria personale nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Ndërsa

sipas nenit 27 të Kushtetutës, askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (*pika 1*) dhe liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj (*pika 2, shkronja "c"*).

24. Gjykata ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor të masave të sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit dhe se këto procedura duhet të kenë karakter gjyqësor dhe të sigurojnë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Heqja e lirisë autorizohet nga dispozitat ligjore, nëpërmjet të cilave urdhërohet ndalimi, zgjatja dhe afatet e ndalimit, si dhe ekzistenca e një mjeti ligjor efektiv në dispozicion të kërkuesit për të kundërshtuar "*ligjshmërinë*" dhe "*kohëzgjatjen*" e ndalimit të tij (*shih vendimin nr. 39, datë 15.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Një prej tyre është ai i caktimit të masës së sigurimit, që kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta (*neni 228*), si dhe përmbushjen e disa kriterëve të veçanta (*neni 229*). Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale (*neni 228, pika 1*).

26. Për sa më lart dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale të ndërthurur me të drejtën për proces të rregullt ligjor, e cila është pretenduar si e cenuar në aspekt të parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe standardit të arsyetimit, do të analizohen në aspekt të këtij në fundit, në kushtet kur shkaku kryesor qëndron në faktin se Gjykata e Lartë nëpërmjet arsyetimit të saj ka vepruar në tejkalim të kompetencave të caktuara nga ligji.

27. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe pavarësisë së brendshme të prokurorit, të garantuara, respektivisht, nga nenet 18, pika 1 dhe 148 të Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se gjyqtarët kanë arsyetuar në mënyrë të ndryshme nga rastet e tjera të ngjashme dhe se ndonëse Gjykata e Lartë ka pranuar argumentet e prokurorisë në rekurs, ky i fundit nuk është bërë nga prokurori i çështjes, i cili ka pasur qëndrim të ndryshëm. Duke mbajtur në konsideratë se, nga njëra anë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e barazisë para ligjit dhe pavarësisë së brendshme të prokurorit, janë të ndërrvarura me atë për cenimin e procesit të

rregullt ligjor dhe, nga ana tjetër, kërkuesi i ka bazuar këto pretendime në argumentet e dhëna nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen e çështjes, ato do të analizohen në këndvështrim të procesit të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

28. Kërkuesi ka pretenduar, në thelb, se caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” i ka kufizuar të drejtën për liri personale, të parashikuar nga nenet 27, pikat 1 dhe 2, shkronja “c” dhe 28, pika 3, të Kushtetutës, si dhe neni 5, pika 1, shkronja “c”, i KEDNJ-së. Akuzat në ngarkim të tij në momentin e paraqitjes së kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit kanë qenë “Falsifikimi i dokumenteve dhe stampave ose i formularëve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 190 dhe 186 të KP-së, jo siç arsyeton Gjykata e Lartë, për veprat penale të parashikuara nga neni 143/3 dhe 190/1 të KP-së.

29. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Zbatimi i standardeve të mësipërme është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, pasi ajo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por, në aspektin e kontrollit kushtetues, ajo verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit

që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues dhe materialeve të depozituara rezulton se në ngarkim të kërkuesit janë dy kallëzime penale të paraqitura nga shtetasi I. K., mbi bazën e të cilave, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr. 1600/2019 për veprat penale “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të KP-së dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 5670/2020 për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi me pasoja të rënda” dhe “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve”, të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 të KP-së.

33. Mbështetur në kërkesën e paraqitur nga organi i prokurorisë, në kuadër të procedimit penal nr. 5670/2020, me vendimin nr. 1545/regj., datë 21.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur masën e sigurimit personal “Arrest me burg” për kërkuesin.

34. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1288 regj., datë 07.05.2021, ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për gjykimin e çështjes penale dhe dërgimin e akteve për shqyrtim në gjykatën kompetente, atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

35. Ndërkohë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përfunduar hetimin për procedimin penal nr. 1600/2019, të regjistruar më parë mbi kallëzimin e shtetasis I. K. dhe ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën për pushimin e tij për veprën penale “Shpërdorim detyre” ndaj punonjësve të ASHK-së, Vlorë, si dhe dërgimin për gjykim për veprat e tjera penale të kërkuesit dhe personave të tjerë.

36. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 101 akti, datë 22.09.2021, ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. 5670/2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. 1600/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

37. Gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 5670/2020. Pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurve Helidon Gjikota dhe A.K. për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143/3 dhe 25 të K.P. [...] - Kthimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe detyrimin e saj për plotësimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal nr. 5670/2020, sipas pjesës arsyetuese të vendimit.[...] 2.*

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Vlorë për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1600 viti 2019 për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i K. Penal [...]”.

38. Në këndvështrim të sa më sipër, kërkuesi tashmë rezulton si person i dyshuar vetëm për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të KP-së.

39. Në datën 10.03.2022 kërkuesi është kthyer nga Britania e Madhe dhe është dorëzuar vullnetarisht pranë Policisë Kufitare në Pikën e Kalimit Kufitar Porti Vlorë.

40. Me vendimin nr. 105 regj. them., datë 12.03.2022, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” ndaj kërkuesit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 105 regj. them., datë 12.03.2022 dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”.

41. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (*gjyqtarit të hetimeve paraprake*) për zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”, caktuar ndaj tij, me një masë siguri më të butë.

42. Gjatë seancës gjyqësore, prokurori A.K., në cilësinë e përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është shprehur dakord para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën e kërkuesit, me arsyetimin se kanë ndryshuar kushtet dhe nevojat e sigurimit. Ai ka kërkuar dy masa siguri personal për kërkuesin, përkatësisht detyrimin për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore dhe masën e sigurimit pasuror.

43. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 165, datë 04.05.2022, ka rrëzuar kërkesën, bazuar në këtë arsyetim: “[...]Gjykata, referuar pretendimeve të kërkuesit dhe mbrojtësit vlerëson se në rastin konkret, nevojat e sigurimit nuk janë zbutur dhe masa e sigurimit “Arrest shtëpie” e caktuar me vendim nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe zbatuar ndaj kërkuesit vazhdon t’i përgjigjet rëndësisë së faktit. Gjendja shëndetësore dhe rrethanat familjare të paraqitura me prova në gjykim nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi nuk rezulton që personi nën hetim nuk mund të kurohet në ambientet e shtëpisë apo t’i rrezikohet jeta dhe rrethanat familjare nuk janë të tilla që të kërkojnë domosdoshmërinë e zëvendësimit të masës së sigurimit. Gjithashtu rezulton se hetimi nuk është mbyllur dhe kërkuesi vazhdon të jetë hetim për disa vepra për të cilin është vendosur masa e sigurimit. Pra, nuk kemi as lehtësim të akuzës nga organi procedues për kërkuesin.”.

44. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 166, datë 18.05.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kryer zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi” me masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues *“Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” dhe “Garancia pasurore”*, të parashikuara nga nenet 234 dhe 236 të KPP-së.

45. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165 datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

46. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1497(307), datë 22.11.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

47. Ndër të tjera, ky kolegji ka arsyetuar: *“20. Kolegji vlerëson se nuk ndodhemi përpara asnjë prej këtyre rrethanave të sipërcituara në nenin 260 të KPP, pasi nuk konstatohet ndonjë ndryshim akuze (nga momenti fillestar kur ndaj të pandehurit është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” deri në momentin e paraqitjes së kërkesës objekt shqyrtimi), e cila mund të parashikojë masë dënimi më të butë dhe masa e re e sigurimit t’i përgjigjet rëndësisë së faktit, ose të dënimit që mund të caktohet më vonë. Veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 190/1 i Kodit Penal për të cilat i dyshuari është akuzuar që në fillim vazhdojnë të jetë e njëjta dhe aktualisht. Gjithashtu konstatohet se, nga momenti i zëvendësimit të masës së sigurimit “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”, bërë nga gjykata e apelit me vendimin nr.60-2022-570, datë 24.03.2022, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (objekt shqyrtimi) për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” me një masë më të butë, nuk ka ndryshuar asnjë rrethanë.”.*

48. Duke iu referuar rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se kërkuesi është i dyshuar për veprat penale “Falsifikimi i vulave dhe stampave ose formularëve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 190 të KP-së. Mbi bazën e kësaj akuze ndaj kërkuesit janë dhënë edhe vendimet nr. 105 regj. them, datë 12.03.2022 dhe nr. 165, datë 04.05.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe vendimet nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022 dhe nr. 166, datë 18.05.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për verifikim ose zëvendësim të masës së sigurisë.

49. Në pikën 2 të nenit 260 të KPP-së përcaktohet: *“Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë.”.* Ligjvënësi e ka lidhur zëvendësimin e një mase sigurimi me zbutjen e nevojave të sigurimit ose me mungesën e përshtatshmërisë midis masës së

zbatuar dhe rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se nuk ka identifikuar ndryshimin e asnjë rrethane nga momenti i zëvendësimit të masës së sigurimit “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, bërë nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 60-2022-570, datë 24.03.2022, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës pranë saj.

50. Kolegji çmon se pavarësisht lapsusit të kryer nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 i KP-së, një fakt i tillë nuk ka ndikuar në vendimmarrjen e tij, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 165, datë 04.05.2022, që është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, u është referuar veprave penale të parashikuara në nenet 186 dhe 190 të KP-së, duke marrë në konsideratë dhe analizuar elementet dhe rrethanat në raport me veprat penale për të cilat dyshohet se janë kryer nga kërkuesi.

51. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesi, përveç ndonjë lapsusi në referim, në tërësinë e tij paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe arsyet se pse lënia në fuqi e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” ishte e nevojshme. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka analizuar dhe vlerësuar vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta në raport me shkaqet e paraqitura në rekurs, faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, në përmbushje të funksionit të saj për të kontrolluar vendimmarrjen e atyre gjykatave. Pretendimi i kërkuesit se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nuk ka qenë në dosjen që ka shqyrtuar Gjykata e Lartë dhe, për pasojë, ajo nuk ka pasur mundësi objektive ta lexonte atë dhe të kuptonte se cilat ishin shkaqet për të cilat është caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe se Gjykata e Lartë ka kopjuar rekursin e prokurorit të apelit, pa verifikuar nëse ishte i vërtetë, është i pambështetur në prova dhe fakte konkrete.

52. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenim të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, është haptazi i pabazuar.

53. Në kushtet kur pretendimet e kërkuesit për cenimin e barazisë para ligjit dhe pavarësisë së brendshme të prokurorit janë bazuar në argumentet e dhëna nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt i gjykimit, të cilat përmbushin në mënyrë të mjaftueshme standardet kushtetuese të arsyetimit, Kolegji çmon se edhe ato janë haptazi të pabazuara.

54. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.